



Ftesë për Shprehje të Interesimit Konsulencë Individuale

Nr.CDF/IC-HR/LS013/2026

Data: 07.09.2026

Ekspert/e për të ndihmuar Institucionin e Avokatit të Popullit në hartimin e një raporti Ex Officio me rekomandime për "Obligimet e shtetit për respektimin e të drejtave të personave me sëmundjen e Alzheimerit dhe forma të tjera të demencës"

Sfondi:

"Human Rightivism" është një projekt trevjeçar (2025–2027) i zbatuar nga Fondi për Zhvillimin e Komunitetit (CDF), me mbështetje financiare nga Ambasada Suedeze/Sida, në kuadër të Strategjisë së Suedisë për Bashkëpunim në Reforma me Ballkanin Perëndimor dhe Turqinë (2021–2027).

Përmes bashkëpunimit me organizatat e shoqërisë civile, institucionet publike dhe palët tjera të interesuara, projekti po hap rrugën drejt një shoqërie më të drejtë, gjithëpërfshirëse dhe reziliente. Duke adresuar sfidat e ndërlidhura që kanë të bëjnë me shëndetin mendor, të drejtat e punës dhe kontestet gjyqësore strategjike, projekti synon të krijojë ndikim të qëndrueshëm dhe të përmirësojë mirëqenien e komuniteteve në Kosovë.

Në kuadër të projektit, CDF ofron mbështetje për Institucionin e Avokatit të Popullit (IAP) në fusha dhe tema të ndryshme të të drejtave të njeriut dhe lirive themelore në përputhje me nevojat e IAP-së. Mbështetja profesionale që ofrohet përfshin analiza profesionale, ndihmë me ekspertë në tema të caktuara dhe hulumtime tematike. Fokusi i kësaj mbështetjeje dhe i projektit në përgjithësi është mbrojtja e interesit të përgjithshëm dhe e të drejtave të njeriut.

Këto Terma të Referencës janë për angazhimin e një eksperti/je për të ndihmuar IAP-në në hartimin e një raporti Ex Officio nga perspektiva e institucionit për "Obligimet e shtetit për respektimin e të drejtave të personave me sëmundjen e Alzheimerit dhe forma të tjera të demencës".

Personat që jetojnë me demencë, përfshirë personat me sëmundjen e Alzheimerit, mund të përballen me sfida të shumta në ushtrimin e të drejtave të tyre, përfshirë qasjen në shërbime të përshtatshme shëndetësore dhe sociale, kujdes afatgjatë, mbështetje në komunitet, mbrojtje nga diskriminimi dhe trajtimi degradues, si dhe respektimin e dinjitetit, autonomisë dhe integritetit personal. Për shkak të natyrës progresive të sëmundjes së Alzheimerit dhe shumicës së formave të tjera të demencës, si dhe nevojës për kujdes dhe mbështetje të vazhdueshme, roli i shtetit është thelbësor në krijimin dhe zbatimin e një kuadri ligjor, institucional dhe të politikave që garanton mbrojtjen efektive të të drejtave të personave që jetojnë me demencë, si dhe mbështetjen e familjarëve dhe kujdestarëve të tyre.

Ekspert/e për të ndihmuar Institucionin e Avokatit të Popullit në hartimin e një raporti Ex Officio me rekomandime për "Obligimet e shtetit për respektimin e të drejtave të personave me sëmundjen e Alzheimerit dhe forma të tjera të demencës"

Terma të referencës

Qëllimi i këtij angazhimi është të ndihmojë Institucionin e Avokatit të Popullit në hartimin e një raporti Ex Officio me rekomandime të IAP-së për "Obligimet e shtetit për respektimin e të drejtave të personave me sëmundjen e Alzheimerit dhe forma të tjera të demencës". Raporti synon të analizojë obligimet e shtetit në garantimin dhe respektimin e të drejtave të këtyre personave, gjendjen aktuale të kujdesit dhe të ofrimit të shërbimeve për ta, sfidat në zbatimin e kornizës ligjore dhe të politikave, si dhe të ofrojë rekomandime konkrete për përmirësimin e mbrojtjes së të drejtave të tyre.

Objektivat e këtij angazhimi

Eksperti/ja do të ndihmojë IAP-në në përgatitjen e një raporti analitik, i cili do të paraqesë situatën aktuale të personave që jetojnë me sëmundjen e Alzheimerit dhe forma të tjera të demencës në Kosovë, me qëllim të krijimit të një pasqyre të qartë mbi përmasat e çështjes, shërbimet ekzistuese dhe nevojat e tyre dhe të familjeve të tyre.

Raporti duhet të përfshijë:

- Shqyrtimin e politikave, legjislacioneve dhe mekanizmeve institucionale relevante, si dhe shërbimeve për personat që jetojnë me sëmundjen e Alzheimerit dhe forma të tjera të demencës, përfshirë diagnostikimin e hershëm, trajtimin, kujdesin shëndetësor, social dhe afatgjatë, si dhe koordinimin ndërmjet institucioneve.
- Shqyrtimin e të dhënave dhe statistikave ekzistuese mbi personat me sëmundjen e Alzheimerit dhe forma të tjera të demencës në Kosovë, përfshirë identifikimin e sfidave në mbledhjen dhe raportimin e të dhënave;
- Nevojat dhe sfidat me të cilat përballen familjarët dhe kujdestarët, përfshirë barrën e kujdesit, nevojën për mbështetje psikosociale, këshillim dhe shërbime mbështetëse;
- Konsultime me institucionet relevante, profesionistët shëndetësorë dhe socialë, organizatat e shoqërisë civile, personat që jetojnë me demencë dhe/ose familjarët dhe kujdestarët e tyre;
- Identifikimin e praktikave të mira dhe modeleve relevante rajonale dhe ndërkombëtare që mund të përshtaten në kontekstin e Kosovës;
- Formulimin e rekomandimeve konkrete për përmirësimin e mbrojtjes së të drejtave të personave që jetojnë me demencë, përfshirë personat me sëmundjen e Alzheimerit.

Detyra e dorëzueshme: Një raport analitik mbi situatën e personave që jetojnë me demencë, përfshirë personat me sëmundjen e Alzheimerit, në Kosovë, i bazuar në të dhëna të disponueshme dhe konsultime me palët relevante. Raporti duhet të përmbajë gjetjet kryesore, boshllëqet e identifikuar, nevojat prioritare dhe rekomandime konkrete dhe të zbatueshme për institucionet dhe aktorët relevantë për respektimin e të drejtave që u takojnë këtyre personave.

Detyrat: Ekspertilja do të jetë përgjegjëse për kryerjen e detyrave të mëposhtme:

Detyrat e dorëzueshme (deliverables)	Numri i ditëve të punës
Metodologjia e punës: pas nënshkrimit të kontratës dhe takimit orientues me Institucionin e Avokatit të Popullit, dorëzohet dokumenti që përmban përshkrimin e metodologjisë së propozuar të punës, planin e punës, burimet që do të shqyrtohen, palët që do të konsultohen dhe mjetet që do të përdoren gjatë analizës.	5
Versioni i parë i raportit: Dorëzimi i versionit të parë të raportit për rishikim nga Institucioni i Avokatit të Popullit dhe për komente dhe kontribute nga palët relevante, duke përfshirë analizën e kornizës ligjore dhe të politikave, të dhënat dhe informacionet e mbledhura, rezultatet e intervistave/konsultimeve, gjetjet, konstatimet dhe rekomandimet paraprake.	10
Raporti përfundimtar: Dorëzimi i raportit përfundimtar që përfshin komentet dhe kontributet e IAP-së dhe palëve relevante, me analizë të plotë, gjetje të argumentuara dhe rekomandime konkrete, të strukturuar qartë dhe të bazuara në dëshmi.	5

Kualifikimet dhe përvoja: Ekspertilja duhet të posedojë kualifikimet dhe përvojën siç vijon:

Diplomë të nivelit të avancuar në njërin nga fushat e mëposhtme:

- Drejtësi: me fokus në të drejtën ndërkombëtare të të drejtave të njeriut, të drejtën kushtetuese, të drejtën shëndetësore ose fusha të ngjashme; ose
- Shëndet publik / menaxhim shëndetësor / mjekësi: me njohuri mbi sistemin shëndetësor, kujdesin për personat e moshuar, shëndetin mendor, sëmundjet neurodegenerative, kujdesin afatgjatë ose organizimin e shërbimeve shëndetësore dhe sociale;
- Shkenca sociale / punë sociale / politika publike ose fusha të ngjashme: me fokus në të drejtat e personave të moshuar, të personave me aftësi të kufizuara dhe të grupeve në situata të cënueshme, politikat sociale ose mbrojtjen sociale.
- Përvojë të paktën 5-vjeçare në hartimin e raporteve analitike, hulumtimeve, analizave ligjore ose të politikave në fushën e të drejtave të njeriut, shëndetësisë, mbrojtjes sociale ose fushave të ngjashme, në vend ose për organizata ndërkombëtare, me dëshmi përkatëse;
- Përvojë paraprake në analizimin ose monitorimin e institucioneve shëndetësore dhe/ose sociale në Kosovë ose rajon; përvoja në çështjet që lidhen me personat që jetojnë me demencë, përfshirë sëmundjen e Alzheimerit, personat e moshuar ose personat me aftësi të kufizuara konsiderohet përparësi.

Kriteret e vlerësimit: Propozimet do të vlerësohen në bazë të kriterëve të mëposhtme:

- Kuptimi i objektivave dhe kërkesave.
- Metodologjia dhe qasja e propozuar.



- Përvoja përkatëse.
- Kualifikimet dhe ekspertiza.
- Konsideratat e kostos dhe të buxhetit.
- Vlerësimi përfundimtar do të peshohet me 80% për aspektin teknik të propozimit dhe 20% për aspektin financiar. Vlerësimi teknik do të bëhet deri në 100 pikë sipas tabelës më poshtë dhe do të konvertohet në peshën prej 80%.

Kriteret e vlerësimit	Pikët
Kualifikimi dhe ekspertiza	30
Metodologjia dhe qasja e propozuar	25
Përvoja përkatëse	25
Të kuptuarit e objektivave dhe kërkesave	20
Totali i pikëve: 100	

Afatet kohore: Parashikohet që detyrat të përfundojnë brenda 20 ditë pune, duke filluar nga data e nënshkrimit të kontratës.

Raportimi dhe Koordinimi: Eksperti/ja do të koordinohet dhe do të bashkëpunojë drejtpërdrejt me Institucionin e Avokatit të Popullit në Kosovë lidhur me punën, analizën dhe veprimet e ndërmarra gjatë angazhimit dhe për këtë do t'i raportojë institucionit dhe CDF-së; do të bashkëpunojë drejtpërdrejt me CDF-në dhe ekipin e projektit "Human Rightivism" sa i përket përmbushjes së obligimeve kontraktuale.

Prona intelektuale: Të gjitha materialet dhe prona intelektuale të prodhuara gjatë përgatitjes së raportit do të jenë në pronësi të Institucionit të Avokatit të Popullit në Kosovë.

Konfidencialiteti: Eksperti/ja do të ruajë konfidencialitetin në lidhje me të gjitha të dhënat dhe informacionin e marrë gjatë angazhimit.

Aplikimi: Ekspertët/et e interesuar duhet të dorëzojnë CV-në e tyre të përditësuar, propozim buxhetin total, një propozim të detajuar që përshkruan qasjen ndaj vlerësimit si dhe dëshmi përkatëse të punës së mëparshme në këtë fushë në email: procurement@kcdf.org më së largu deri me **21.09.2026, deri në ora 14:00**.